



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 1102 prot.

Shkodër, më 16.01. 2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni.

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin:

“PËR NJE NDRYSHIM NË VKB NR.27 DATË 01.06.2016 “PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR, SHPERBLIMIN E ANËTARËVE TIJ DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TE PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE, SPORTIVE, RINORE DHE PROMOVIMIN E TERRITORIT NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR”

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 1402/11 prot.

Shkodër, më 16.07. 2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë _____. 2026

“PËR NJE NDRYSHIM NË VKB NR.27 DATË 01.06.2016 “PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR, SHPERBLIMIN E ANËTARËVE TIJ DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TE PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE, SPORTIVE, RINORE DHE PROMOVIMIN E TERRITORIT NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____/____/2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 25 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjin nr.44/2015“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimin nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave“Për krijimin e këshillave artistiko - kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, të ndryshuar; “Udhëzimin nr.1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko - kulturor”, VKB nr.27, date 01.06.2016 “ Per ngritjen e Keshillit artistiko kuturore, artistike, sportive dhe rinore, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në bashkinë Shkodër” të ndryshuar; VKB nr.84 datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit nr. _____ prot, datë _____ të Drejtorisë së Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit;

VENDOSI :

1. Të miratojë një ndryshim në VKB nr.27, datë 01.06.2016 “Për ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor, shperblimin e anëtarëve tij dhe miratimin e rregullores së financimit te projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë shkodër” të ndryshuar, si më poshtë:
 - a) Të miratojë ngritjen e këshillit artistiko-kulturor pranë bashkisë Shkodër, për një periudhë dy vjeçare 2026-2028, si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Aktiviteti i tyre në shërbim të artit, kulturës dhe sportit
1	Sara Smajaj	Drejtor i Drejtorsë së Kulturës, Drejtorja e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit
2	Zyliha Miloti	Aktore e Teatrit dhe filmit, Mjeshter i Madh
3	Zef Çoba	Kompozitor, Mjeshtër i Madh
4	Ridvan Karakaçi	Muzikolog dhe kritik arti
5	Roland Guli	Kompozitor, profesor në Departamentin e Arteve, Universiteti "Luigj Gurakuqi"
6	Andi Hila	Piktor, visual art, profesor në Departamentin e Arteve, Universiteti "Luigj Gurakuqi"
7	Arbana Bekteshi	Mjeshter i Madh, Mjeshter i Meritur në atletikë, profesor në Departamentin e Arteve, Universiteti "Luigj Gurakuqi"

2. Pikat e tjera të VKB-se nr.27, datë 01.06.2016, të ndryshuar, mbeten në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

Me vendim delegimi

Zv/Kryetar

Alban PREKA

Zv/Kryetar

Rudin BEKA

Drejtorja e Përgjithshme e Kulturës,
dhe e Sportit

Pandi LAÇO

Drejtor i Kultures

Sara SMAJAJ

Drejtorja e Përgjithshme Juridike,
Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Griselda DAMA

Drejtorja Juridike

Brikena LEQEJZA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KULTURËS DHE SPORTIT
DREJTORIA E KULTURËS

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2026

RELACION

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 27 DATË 01.06.2016 “PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR, SHPERBLIMIN E ANËTARËVE TIJ DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TE PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE, SPORTIVE, RINORE DHE PROMOVIMIN E TERRITORIT NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR”

Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Vizioni i politikave kulturore të bashkisë është ndërtimi i një jete kulturore aktive, gjithëpërfshirëse dhe cilësore, që i shërben zhvillimit të komunitetit, rritjes së identitetit lokal dhe nxitjen e turizmit kulturor në funksion të përmirësimit të ekonomisë lokale.

Gjatë viteve të fundit mbështetja për realizimin aktivitete artistiko - kulturore, sportive, rinore dhe promovimit të territorit është rritur nëpërmjet shtimit të fondeve të parashikuara për realizimin e projekteve të paraqitura nga subjekte të ndryshme të fushave përkatëse.

Kjo mbështetje financiare kryhet në përputhje me projektet dhe fondet e përcaktuara për këtë qëllim nga bashkia e Shkodrës sipas miratimit nga Këshilli Bashkiak të Buxhetit të vitit përkatës.

Këshilli Artistiko-Kulturor mbështet bashkinë Shkodër në vlerësimin e cilësisë së projekteve të paraqitura nga subjektet e interesuara, projekte që i shërbejnë realizimit të objektivave të bashkisë në fushën e zhvillimit të artit, kulturës sportit, rinisë dhe promovimit të territorit në bashkëpunim me këto subjekte. Anëtarët e këshillit artistiko-kulturor kanë mandat 2 vjeçar.

Këshilli Artistik, si organ këshillimor profesional, ka luajtur një rol të rëndësishëm në orientimin, vlerësimin dhe garantimin e cilësisë artistike të veprimtarive kulturore të organizuara nga bashkia. Gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të tij, Këshilli Artistik ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në përzgjedhjen e projekteve kulturore, në dhënien e mendimeve profesionale për projekteve artistike, si dhe në përmirësimin e standardeve të aktiviteteve të ofruara për komunitetin.

Anëtarët aktualë të Këshillit Artistik kanë krijuar një praktikë pune të konsoliduar, kanë njohuri të thella mbi realitetin kulturor lokal dhe kanë ndërtuar bashkëpunim efektiv me strukturat përkatëse të bashkisë. Kjo eksperiencë përbën një vlerë të shtuar që do të ishte në interes të institucionit dhe komunitetit të ruhej dhe të vijonte edhe në periudhën 2026–2028.

Ripërtëritja e afatit 2 (dy) vjeçar për periudhën 2026–2028 do të sigurojë vazhdimësi institucionale, stabilitet profesional dhe rritje të cilësisë artistike në aktivitetet e bashkisë.

Sa më sipër në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; VKM nr 121 datë 25.2.2005, per disa ndryshime ne vendimin 540, datë 21.12.1992, "Për krijimin e Këshillave të Kulturës dhe shpërblimin e tyre"si dhe të Udhëzimit Nr 1, datë 24.05.2005 të Ministrisë se Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko –kulturore”, VKB nr.84 datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër",

Propozojmë për miratim Keshillit Bashkiak projekt vendimin “Për nje ndryshim në VKB nr. 27 datë 01.06.2016 “Për ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor, shperblimin e anëtarëve tij dhe miratimin e rregullores së financimit te projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë Shkodër, të ndryshuar”.

Lista e propozuar per Keshillin Artistiko Kulturor per dy vitet e ardhshme 2026-2028 është si më poshtë:


Nr.	Emër Mbiemër	Aktiviteti i tyre në shërbim të artit, kulturës dhe sportit
1	Sara Smajaj	Drejtor i Drejtorsë së Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit
2	Zyliha Miloti	Aktore e Teatrit dhe filmit, Mjeshter i Madh
3	Zef Çoba	Kompozitor, Mjeshtër i Madh
4	Ridvan Karakaçi	Muzikolog dhe kritik arti
5	Roland Guli	Kompozitor, profesor në Departamentin e Arteve, Universiteti “Luigj Gurakuqi”
6	Andi Hila	Piktur, visual art, profesor në Departamentin e Arteve, Universiteti “Luigj Gurakuqi”
7	Arbana Bekteshi	Mjeshter i Madh, Mjeshter i Meritur në atletikë, profesor në Departamentin e Arteve, Universiteti “Luigj Gurakuqi”

Duke Ju falenderuar !

Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit


Pandi Laço

Drejtoria e Kulturës


Sara Smajaj

Drejtoria e Sportit


Auron Miloti

KRYETAR

Benet BECI

Me vendim delegimi

Zv/Kryetar

Alban PREKA

